

## **ÇËSHËTJA E SHQIPTARËVE NË JUGOSLLAVI NË SFONDIN E MARRËDHËNIEVE NDËRMJET SHQIPËRISË DHE JUGOSLLAVISË, 1918-1939**

(Skënder Lutfiu, *Çështja e shqiptarëve në Jugosllavi në sfondin e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, 1918-1939*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, 2021, 624 f.)

Instituti i Historisë në Prishtinë botoi kohët e fundit studimin monografik “Çështja e shqiptarëve në Jugosllavi në sfondin e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë ,1918-1939” të dr. Skënder Lutfiut. Botimi ka një këndvështrim origjinal në trajtimin e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë në periudhën midis dy luftërave botërore. Në këto raporte shfaqet çështja e gjendjes së popullsisë shqiptare në Mbretërinë SKS - Mbretërinë e Jugosllavisë, të shkëputur nga shteti kombëtar shqiptar kryesisht që nga viti 1913 me vendimin e Fuqive të Mëdha. Në historiografinë shqiptare, deri më sot, nuk është trajtuar tematika e kësaj monografie në përmasat e një vëllimi të veçantë, pra deri në thellësinë dhe gjerësinë e duhur.

Studiuesi Lutfiu ka arritur të përballojë sfidën e trajtimit të marrëdhënieve diplomatike ndërshtetërore midis dy vendeve nga këndvështrimi që nxjerr në pah shumë probleme në një hark kohor prej rreth dy dekadash. I mbështetur në dokumente arkivore të disa burimeve, së pari në ato të arkivave të shtetit shqiptar, si dhe në burime serioze bibliografike, autori ka nxjerrë rezultate të kënaqshme për disa nga çështjet që kanë qenë dhe janë ende objekt trajtimi në historiografinë shqiptare. Duhet theksuar se autorit të monografisë, duke synuar nëpërmjet saj të pasqyrojë në mënyrë objektive trajtimin e çështjes së shqiptarëve në Jugosllavi në kuadër të marrëdhënieve të Shqipërisë dhe Jugosllavisë, i është dashur të analizojë publikimet kryesore të studiuesve paraardhës. Gjatë kësaj pune voluminoze, atij i është dashur të bëjë përmbledhjen e arritjeve të historiografisë shqiptare mbi këtë çështje, duke i krahasuar me faktet dhe konkluzionet e historiografisë jugosllave dhe asaj të disa vendeve të tjera. Kjo ka qenë edhe rruga e duhur për të sjellë

rezultate autentike. Mbi këtë bazë bibliografike të pasuruar me materialin dokumentar të hulumtuar rishtazi, S. Lutfiu, në të gjithë nënçështjet, ka sjellë këndvështrimin e tij, që do ta konsideroja një vlerë të shtuar në historiografinë shqiptare. Ndër çështjet e para që janë trajtuar në këtë studim është ajo rreth përcaktimit të vijës kufitare ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë që në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore ishte me shumë ndikim në marrëdhëniet ndërshtetërore midis dy vendeve. Kjo problematikë nisi me ripushtimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në tetorin e vitit 1918 dhe me formimin e Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene në dhjetor të po atij viti. Me ç'rast territoret shqiptare, që u inkuadruan në vitin 1913 brenda kufijve të Serbisë dhe të Malit të Zi, mbetën sërish jashtë shtetit shqiptar dhe u përfshinë brenda shtetit serbo-kroato-slloven përsëri me vendimet e Fuqive të Mëdha. Madje ky shtet paraqiti pretendime për të shkëputur territore të tjera nga Shqipëria politike. Si pasojë e këtij diskursi, si dhe të përpjekjeve të vazhdueshme të Beogradit për spastrimin etnik të Kosovës nëpërmjet dhunës dhe terrorit mbi popullsinë shqiptare, ndërmjet Tiranës dhe Beogradit u krijua një klimë tensioni dhe u shkëmbyen akuza, të cilat u përcollën edhe në instancat ndërkombëtare, si në Konferencën e Paqes në Paris apo në Lidhjen e Kombeve etj. Këtu përfaqësuesit shqiptarë dhe ata jugosllavë jo rrallë u përplasën si pasojë e qasjes diametralisht të kundërt ndaj çështjes së shqiptarëve në Jugosllavi.

Në këtë situatë konfliktuale, konkludohet me të drejtë në monografinë e S. Lutfiut, nuk mund të pretendohet për krijim të raporteve të ndërsjella fqinjësore normale, ndonëse përpjekjet nga pala shqiptare nuk munguan asnjëherë. Në këtë situatë të acaruar gjendeshin edhe shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera etnike, të cilët nuk mund të qëndronin indiferentë përballë politikës së dhunës dhe shkombëtarizimit nga Mbretëria Jugosllave. Ata formuan Komitetin e Kosovës dhe organizuan rezistencën e armatosur guerile (Lëvizjen Kaçake) duke siguruar sa ishte e mundur ndihmën e shtetit shqiptar, i cili ishte jo vetëm strehë për atdhetarët kosovarë, por edhe i angazhuar vazhdimisht për t'i ndihmuar ata dhe për të ndërkombëtarizuar çështjen e Kosovës. Autori Lutfiu konstaton se edhe Komiteti i Kosovës edhe Lëvizja e Armatosur në Kosovë objektivisht kanë qenë shkak i ashpërsimit të marrëdhënieve diplomatike midis Beogradit zyrtar dhe Tiranës, i pari akuzonte të dytën se po nxiste separatistët kosovarë të destabilizonin Jugosllavinë duke ndërhyrë kështu në punët e saj të brendshme. Kjo deri në njëfarë mase ishte reale duke llogaritur se Komiteti i Kosovës e kishte selinë në Shkodër, pra brenda

territorit të shtetit shqiptar, e madje kreu i tij, Kadri Prishtina, mbante postin e ministrit të Drejtësisë në qeverinë e dalë nga Kongresi i Lushnjës, ndërsa shumë anëtarë të këtij Komiteti, si Hasan Prishtina, Bajram Curri etj., jo vetëm që veprimtarinë e tyre e zhvilluan në Shqipëri, por morën aty edhe pozita të larta shtetërore.

Në monografi trajtohet edhe situata mjaft konfliktuale dhe jostabile në Shqipëri për shkak të përplasjes së forcave të ndryshme në pozitë ose në opozitë, e shfaqur me kryengritje të përsëritura, me atentate etj. Me të drejtë autori konstaton se përplasjet e ashpra politike dëshmonin jo vetëm papjekurinë e klasës politike shqiptare dhe nivelin shumë të ulët të njohjes së parimeve demokratike, por edhe shfrytëzimin e këtyre dobësive nga fqinjët për të penguar konsolidimin e shtetit shqiptar, si edhe për të bërë sa më të paefektshëm, në mos për ta neutralizuar krejt mbështetjen e “shtetit amë” për shqiptarët e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare.

Sipas Skënder Lutfiut, Shqipëria si shteti amë i shqiptarëve në Jugosllavi, me gjithë problemet e shumta të brendshme dhe shpërfilljen në marrëdhëniet ndërkombëtare nga fuqitë rajonale dhe Fuqitë e Mëdha, bëri përpjekje serioze për bashkatdhetarët matanë kufirit. Këto përpjekje në mos çonin për zgjidhjen e çështjes së shqiptarëve në Jugosllavi, çka ishte e pamundur për shkak të marrëveshjeve ndërkombëtare që nuk lejonin një gjë të tillë, së paku u tentua të vlenin për ndaljen e dhunës dhe trajtimin më të mirë të shqiptarëve nga regjimi i Beogradit. Shqipëria, thekson autori, u përpoq sa mundi në Konferencën e Paqes në Paris, në Lidhjen e Kombeve dhe në kontaktet diplomatike dypalëshe me vendet e tjera për të mos e lënë në heshtje çështjen e bashkëkombësve në Jugosllavi, por rezultatet e këtyre përpjekjeve mbeten të diskutueshme.

Një çështje tjetër që autori ka bërë objekt të vëmendjes së tij në monografi është ajo e Manastirit të Shën Naumit dhe e Vermoshit, që në periudhën 1921-1925 në marrëdhëniet dypalëshe midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë ka qenë trajtuar gjerësisht. Në monografi përmenden mjaft fakte të njohura, por të interpretuara jo njësoj, se si për këtë çështje, ku u involvua edhe diplomacia ndërkombëtare, duke interpretuar vendimet e Konferencës së Londrës të vitit 1913, iu njoh Shën Naumi Shqipërisë. Gjithsesi, ajo nuk tregoi asnjë dëshirë për të imponuar zbatimin e vendimit që mori. Pas rikthimit të A. Zogut në pushtet në dhjetor 1924, çështja u mbyll me një marrëveshje ndërmjet palës shqiptare dhe asaj jugosllave që ia la Manastirin e Shën Naumit Jugosllavisë, kundrejt ndonjë rektifikimi kufitar. Më tej, S. Lutfiu konkludon se Zogu nuk mund të fajësohet për këtë lëshim, sepse ishte Parlamenti që vendosi të miratojë marrëveshjen.

Gjithsesi, mban qëndrim autori, sikurse edhe një pjesë e studiuesve që kanë trajtuar këtë temë, se kjo çështje përfundoi në favor të jugosllavëve edhe si pasojë e diskursit që ndoqi Ahmet Zogu lidhur me këtë situatë.

Në monografi janë zbërthyer përmes një strukture të qëndrueshme të organizimit të materialit, dhe faktologjisë e interpretimeve të argumentuara, momentet më interesante të luhatjeve në marrëdhëniet diplomatike midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë të cilat kanë qenë prezente qoftë në periudhën e Republikës (1925-1928), qoftë në atë të Monarkisë (1928-1939). Çështja e shqiptarëve në Jugosllavi gjatë gjithë kësaj periudhe vlerësohet si faktor në acarimin dhe në përplasjet diplomatike ndërmjet dy vendeve. Rasti Gjurashkoviç, rasti i vrasjes së Shtjefën Gjeçovit, çështja e emigrantëve shqiptarë të Kosovës etj., ishin disa nga problemet që acaruan marrëdhëniet ndërshtetërore, tejkalimi i të cilave ishte mjaft sfidues për shtetin shqiptar.

Përfshirja në jetën politike e shqiptarëve në Jugosllavi dhe situata me liritë dhe të drejtat e tyre, është një tjetër aspekt me rëndësi që autori Luftiu e ka shtjelluar në një kapitull të veçantë. Në këtë kuadër janë ofruar të dhëna me interes për krijimin dhe veprimtarinë e Xhemijetit, partisë së vetme që përfaqësonte shqiptarët në Jugosllavi në periudhën midis dy luftërave botërore. Edhe pse ky subjekt politik ishte veshur me mbulesë religjioze, Xhemijeti në vitet e veprimtarisë së tij, arriti që nëpërmjet deputetëve të vet në Parlamentin jugosllav jo vetëm të përfaqësonte interesat e shqiptarëve, por edhe të reagoonte fuqishëm kundër krimeve që kryente ndaj tyre pushteti i Beogradit. Në artikujt e gazetës “HAK”, organit të Xhemijetit, pasqyrohej situata e rëndë që ekzistonte për shqiptarët në Jugosllavi. Edhe pas shuarjes, në vitin 1925, të këtij subjekti politik, shqiptarët u përpoqën të gjejnë zgjidhje duke u përfshirë në jetën politike të vendit nëpërmjet subjekteve politike serbe të pozitës dhe opozitës. Disa prej tyre, në zgjedhjet parlamentare të viteve 1930, arritën të siguronin edhe mandatin e deputetit çka iu mundësoi veçanërisht kur ishin pjesë e opozitës, të akuzonin me fakte politikën e qeverisë ndaj shqiptarëve. Janë të njohura fjalimet e zëshme të deputetëve shqiptarë, si Ferhat Draga, Ramë Bllaca, Sherif Voca etj., të cilat nuk kaluan pa gjurmë në skupshtinën e Jugosllavisë.

Në fund, mund të themi që monografia e dr. Skënder Lutfiut, pasuron më tej historiografinë shqiptare, sepse trajton me vërtetësi dhe individualitet një temë që ka pasur dhe do të ketë edhe më tej nevojë të hulumtohet. Konstatoj me kënaqësi se autori, ndonëse relativisht i ri, me ambicien për t’u evidentuar si studiues serioz, ka sjellë një vepër që

---

plotëson bibliografinë e historiografisë shqiptare dhe besoj do të jetë burim referimi për studiues të mëvonshëm, por edhe për gjithkënd që dëshiron të pasurojë kulturën e tij historike përmes literaturës së mirëfilltë shkencore.

**Akademik Marenglen VERLI**